

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar

Furnizimi i arit të përpunuar

Referuar Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vlerën e tatueshme të arit të përpunuar, të importuar dhe arin e përpunuar të furnizuar brenda vendit, nuk përfshihet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

Po kështu, në vlerën e tatueshme të një importi apo furnizimi brenda vendit, përfshihen përbërës materialë të tillë si:

- a) argjend,
- b) gurë të çmuar,
- c) lëndë plastike,
- d) vlera e punës së gjallë, firo të përpunimit, etj.

Lënda e parë ar e përdorur për prodhimin e bizhuterive, matet dhe konvertohet në ar me përmbajtjen më të lartë të arit të pastër në të 999,9%, ose ar 24 karat. Në kushtet e përpunimit, lidhja, ar i përdorur si lëndë e parë, me metale të tjera, krijon kategori të ndryshme ari që dallojnë nga njëra-tjetra nga përqindja e arit të pastër.

Cilësia e arit e shënuar në faturë

Në çdo bizhuteri është e stampuar edhe shifra “për mijë” e arit të pastër në të. Kjo shifër detyrimisht paraqitet në faturën e importit dhe faturën tatimore për furnizimet brenda vendit. Nëse numri i stampuar është 750, atëherë lidhja është klasifikuar 18 karat dhe përmban 7,50 gram ar të pastër në 10 gram të lidhjes gjithsej.

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të importuar

Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet në përputhje me legjislacionin doganor e atë tatimor. Vlerës së tatueshme, i zbritet vetëm vlera e arit të përdorur si lëndë e parë. Dokument bazë justifikues është fatura e shitësit të huaj, lëshuar në adresë të blerësit vendas. Nga vlera gjithsej e mallit të importuar, në faturë detyrimisht duhet të paraqitet veçmas, vlera e arit të konvertuar në ar të pastër, si dhe në valutë.

Kujdes!

Mungesa e një ndarje të tillë të vlerës së një furnizimi, nuk i jep të drejtën importuesit për të mospërfshirë në vlerën e tatueshme të importit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Nga vlera gjithsej që paraqitet në faturë, zbritet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë dhe shuma që del, është e barabartë me vlerën e tatueshme që merret për bazë edhe për llogaritjen e TVSH-së.

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të furnizuar brenda vendit

Vlera e furnizimit brenda vendit është sa pagesa e plotë e atij furnizimi. Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, llogaritet, duke zbritur nga pagesa e plotë e furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Dokument bazë justifikues është fatura e furnizuesit, person i tatueshëm, e lëshuar në adresë të blerësit, e cila paraqet të ndarë veçmas vlerës totale të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Kujdes!

Mungesa e një ndarjeje të tillë të vlerës së një furnizimi brenda vendit, nuk i jep të drejtë furnizuesit që të mospërfshijë në vlerën e tatueshme të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Pavarësisht natyrës së furnizimit, me shumicë apo me pakicë dhe pavarësisht vlerës së furnizimit, nga furnizuesi person i tatueshëm, lëshohet faturë tatimore siç përcaktohet në nenin 101 të Ligjit.